



**RREGULLORE**

**E EDUKIMIT NË VAZHDIM NË**

**PSIKOLOGJI**

## HYRJE

Qëllimi i Rregullores së Edukimit në Vazhdim në Psikologji është rritja e vazhdueshme e njohurive dhe zhvillimi i aftësive profesionale të psikologëve, në funksion të përmirësimit të shërbimit të psikologjisë në vend.

Komisioni i Edukimit në Vazhdim në Psikologji (KEVP) është organ i Urdhrit të Psikologut përgjegjës për:

- planifikimin, bashkërendimin dhe zbatimin e programeve të formimit të vazhdueshëm të psikologëve;
- bashkërendimin e punës dhe realizimin e procesit të akreditimit të programeve dhe veprimtarive të edukimit në vazhdim në psikologji;
- mbarëvajtjen e procesit të rilicencimit të psikologëve;
- realizimin e studimeve të vlerësimit të nevojave për formim të vazhdueshëm për të gjithë specialitetet e psikologjisë, në përgjithësi;
- hartimin dhe/ose miratimin e programeve të aktiviteteve të edukimit profesional fillestar ose vazhdues, kur nga aktet ligjore e nënligjore, kërkohet që këto aktivitete të kryhen drejtpërdrejt nga Urdhri i Psikologut.

## KREU I

### PARIMET E EDUKIMIT NË VAZHDIM

1. Psikologu e planifikon vetë pjesëmarrjen në aktivitete të edukimit në vazhdim, bazuar në nevojat e tij profesionale, nevojat e identifikuara nga institucioni ku ushtron aktivitetin dhe kompetencat e dëshiruara.
2. Psikologu zgjedh ato aktivitete që bazohen në nevojat e perceptuara nga ai vetë, si dhe në ato që janë identifikuar nga vlerësime të tjera.
3. Aktiviteti i edukimit në vazhdim duhet të ketë lidhje me specialitetin, rolin profesional dhe përgjegjësitë që ka psikologu në pozicionin aktual të punës.
4. Psikologu duhet të jetë i angazhuar për të ruajtur profesionalizmin gjatë gjithë kohës së ushtrimit të profesionit dhe në kujdesin që ofron, përmes përmirësimit të vazhdueshëm.
5. Psikologu synon ta integrojë procesin individual të të mësuarit në atë të ekipit me të cilin punon, grupeve të kolegëve apo komunitetin e gjerë.

6. Urdhri i Psikologut ndihmon në çdo rast psikologun, në rastet kur duhet t'i krijohen mundësitë dhe kushtet e përshtatshme nga strukturat dhe institucionet ku është i punësuar, për ndjekjen e aktiviteteve të edukimit në vazhdim, duke lehtësuar pjesëmarrjen e tij në këto aktivitete dhe duke ndërmjetësuar, kur është e nevojshme, mes tij dhe institucioneve.

## **KREU II**

### **RILICENCIMI I PSIKOLOGËVE**

#### **1. Numri i krediteve të kërkuara**

1. Kreditet e edukimit në vazhdim janë tregues të sasisë dhe cilësisë së ndjekjes së aktiviteteve të edukimit në vazhdim nga profesionistët e psikologjisë.
2. Brenda një cikli 5-vjeçar, psikologët duhet të mbledhin një numër jo më të vogël se 100 kredite të edukimit në vazhdim. Numri i nevojshëm për rilicencim i krediteve të edukimit në vazhdim, që një psikolog duhet të mbledhë, sipas kategorive të aktiviteteve, është si më poshtë:
  - 2.1. Kreditet e përfituara nga aktivitete të edukimit në vazhdim, të lidhura drejtpërdrejt me fushën e kompetencës apo fushën ku ushtron profesionin psikologu, duhet të përbëjnë të paktën 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve që nevojiten për efekt rilicencimi;
  - 2.2. Kreditet e përfituara nga aktivitete të vetëraportuara përlllogariten deri në 50% të numrit të përgjithshëm të krediteve, që nevojiten për efekt rilicencimi.
  - 2.3. Pjesa tjetër e krediteve të nevojshme përcaktohet nga zgjedhja e lirë e psikologut, në bazë të nevojave individuale
  - 2.4. Numri vjetor minimal i detyrueshëm i krediteve të edukimit në vazhdim për psikologët është 10 kredite. Në rast mosplotësimi të numrit vjetor minimal të krediteve, psikologu duhet ta plotësojë atë brenda 6 mujorit të parë të vitit pasardhës. Njoftimi për detyrimin e përmbushjes së këtij afati konsiderohet i bërë zyrtarisht nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Urdhrit të Psikologut të listës së psikologëve që e kanë përmbushur këtë detyrim. Ky afat mund të shtyhet nga KEVP, vetëm për arsye objek vtive, të provuara me dokumentacion

shoqërues. Mos përmbushja e këtij detyrimi sjell pezullimin e së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në përmbushje të tij.

- 2.5. Psikologët të cilët përgjatë një periudhe kohore të caktuar, e cila përkon brenda periudhës 5 vjeçare të vlefshmërisë së Licencës, nuk janë anëtarë aktiv të Urdhrit të Psikologut, për arsye se mund të kenë kërkuar pezullimin e përkohshëm të anëtarësisë, mund të jenë ndëshkuar me masë disiplinore nga Komisioni Etik, mund të jenë me leje Lindje apo raport mjekësor për arsye shëndetësore, si dhe për çdo arsye tjetër objektive që nga komisioni do të vlerësohet se ka penguar psikologun në mundësinë për të ndjekur aktivitetet e akredituara me qëllim marrjen e krediteve, të mos kenë më detyrimin për plotësimin e 100 krediteve brenda afatit 5 vjeçar, por të një numri më të ulët, në raport të drejtë me kohën në të cilën këta psikologë nuk kanë patur mundësinë objektive për të ndjekur aktivitetet e Edukimit në Vazhdim. Përcaktimi i numrit të krediteve bëhet nga Komisioni i Edukimit në Vazhdim
3. Në fund të secilit cikël 5-vjeçar të programit të rilicencimit, Urdhri i Psikologut njofton në faqen zyrtare psikologët për përmbushjen e kërkesave për rilicencim dhe njofton, kur është e nevojshme, institucionet për statusin e licences të psikologëve të punësuar në to.
4. Në përmbushje të kriterëve të mësipërme, në fund të ciklit 5-vjeçar, psikologu pajiset me Lejen e re të Ushtrimit të Profesionit. Mos përmbushja e këtij detyrimi sjell pezullimin e së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në kalimin me sukses të Provimit të Rilicencimit që kryhet nga Urdhri i Psikologut.
5. Urdhri i Psikologut është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e provimit për kategorinë e psikologëve, të cilët në përfundim të vlefshmërisë së licencës nuk kanë plotësuar kreditet e nevojshme për rilicencim.
6. Organizmi, mënyra e funksionimit, zhvillimi dhe administrimi i Provimit të Rilicencimit të psikologëve, rregullohet nga Rregullorja e Provimit të Rilicencimit të Psikologut, e miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut.
7. Kategoria e psikologëve, të cilët provojnë se kanë më shumë se 20 vite punë të dokumentuar në fushën e psikologjisë, nuk kanë detyrimin e plotësimit të 100 krediteve të nevojshme për rilicencim sipas parashikimeve të kësaj rregullore, por rilicencohen automatikisht me plotësimin e 30 krediteve në 5 vite, bazuar në kërkesën e paraqitur nga psikologu bashkëshoqëruar me dokumenta provuese.

8. Detyrimi i përftimit të krediteve përfundon vetëm në momentin e përmbushjes së 20 viteve eksperiencë punë. Psikologu është i detyruar të përftojë kredite deri në këtë moment, sipas të gjitha rregullave të parashikuara në Rregulloren e Edukimit në Vazhdim.

9. Kjo kategori ka të drejtën e supervizimit ndaj psikologëve praktikantë, të cilët kryejnë praktikën profesionale. Marrëdhënia financiare ndërmjet supervisorit dhe praktikantit rregullohet me marrëveshje mes palëve dhe duhet të vërtetohet me dokumentacionin provues. Mundësia e përfitimit të të ardhurave financiare për shkak të supervizimit nga kjo kategori psikologësh, nuk përbën shkelje të Kodit Etik e Deontologjik të Psikologut.

### **KREU III**

#### **LLOJET E AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM, STANDARDET, KREDITET DHE PROCEDURAT**

Aktivitet e edukimit në vazhdim, të vlefshme për efekt rilicencimi, kategorizohen si më poshtë:

- A. Aktivitete me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë
- B. Aktivitete të edukimit në distancë
- C. Aktivitete të vetëraportuara nga psikologu
  - C.1. Aktivitet individual kërkimor/studimor
  - C.2. Supervizimi

#### **A. AKTIVITETE ME PJESËMARRJE TË DREJTPËRDREJTË (STANDARDET, KREDITET DHE PROCEDURAT)**

##### **1. Format e aktiviteve me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë të akredituara paraprakisht**

Aktivitetet e edukimit në vazhdim, me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë, që akreditohen nga KEVP-ja, mund të jenë:

- “Konferenca” ose aktivitete të ngjashme me kohëzgjatje 1-5 ditore, për një temë të caktuar, e zhvilluar nga institucione publike ose private, të cilat kanë në përbërje të tyre një bord shkencor, ku mbahen një seri leksionesh nga ekspertë të fushës, e organizuar në seanca plenare dhe/ose seanca paralele. Qëllimi i aktivitetit është të shtojë njohuritë e audiencës profesionale, kryesisht mbi të rejat e fundit të profesionit, në lidhje me praktikën përkatëse në fushën e psikologjisë;
- “Trajnimi” ose aktivitete të ngjashme, me kohëzgjatje nga 1 deri 25 ditë efektive, pavarësisht shpërndarjes së tyre në kohë, me qëllim përfundimin e njohurive, aftësive dhe shprehive praktike, që nevojiten për të përmbushur detyrat dhe misionin e ushtrimit të profesionit në mënyrë të kënaqshme. Ai përfshin përdorimin e metodave të ndryshme dhe jo thjesht mbajtjen e leksioneve.
- “Seminari” ose aktivitete të ngjashme,, ku një grup i vogël pjesëmarrësish mësojnë rreth një çështjeje të caktuar dhe marrin pjesë aktivisht, nëpërmjet diskutimit të artikujve të caktuar, prezantimit të studimeve të ndryshme, pyetjeve dhe debateve;
- “Workshop” ose aktivitete të ngjashme, të zhvilluar me një grup të vogël pjesëmarrësish, të cilët përfshihen aktivisht në diskutime, zgjidhje problemesh ose në kryerjen e një teknike, procedure apo manipulimi me ndihmën e një eksperti. Qëllimi është që pjesëmarrësit të mësojnë, duke provuar, gabuar dhe korigjuar vetë ose me ndihmën e të tjerëve, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për praktikën e tyre të përditshme;
- “Prezantimi i një leksioni” ose aktivitete të ngjashme, që nxitin edukimin në vazhdim profesional. Leksioni është një prezantim me gojë, nga një profesionist i kualifikuar dhe me përvojë në fushën përkatëse, i një teme të caktuar, të përgatitur mirë, për rreth 50 deri në 90 minuta, i shoqëruar me pyetje-përgjigje. Aftësitë komunikuese, prezantuese dhe ekspertiza janë cilësitë kryesore të një lektori të mire. Leksionet mund të jenë të organizuara edhe në “Cikël leksionesh”.
- “Grup rishikimi” ose aktivitete të ngjashme,, të organizuara në një grup të vogël (5-10 vetë), ku profesionistët e të njëjtit specialitet ose shërbim mblidhen për të diskutuar për çështje kryesore që lidhen me praktikën e tyre

profesionale, me cilësinë e shërbimit dhe zgjidhjet e mundshme. Qëllimi kryesor i grupeve të rishikimit është shkëmbimi i përvojave dhe vlerësimi i punës së njëri-tjetrit, zgjidhja e problemeve praktike, hartimi i udhëzuesve për të përmirësuar shërbimin. Grupet e rishikimit mbledhen rregullisht dhe drejtohen nga një drejtues grupi;

---

## **A1. OFRUES TË AKTIVITETEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM ME PJESËMARRJE TË DREJTPËRDREJTË**

1. Ofrues të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm në psikologji janë të gjitha strukturat publike ose private, akademike ose joakademike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, që kanë ekspertizën dhe eksperiencën e duhur në organizimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim në fushën e psikologjisë dhe që plotësojnë standardet e kriteret e paraqitura në vijim në këtë rregullore.

### **1.1. Kriteret teknike që duhet të plotësojë ofruesi për një aktivitet të edukimit në vazhdim**

1. Ofruesi duhet të ketë të përcaktuar “ofrimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për psikologët” në objektin e veprimtarisë së tij.
2. Ofruesi duhet të provojë, nëse ka, një historik të organizimeve korrekte, në përputhje me kriteret dhe standardet e edukimit në vazhdim, siç përcaktohen në këtë rregullore.
3. Ofruesi duhet të provojë besueshmëri ekonomike dhe financiare për kryerjen e aktivitetit.
4. Ofruesi duhet të provojë që ka burimet njerëzore që garantojnë kryerjen e aktivitetit të edukimit në vazhdim. Këtu duhet të përshihen:
  - a. koordinatori shkencor, përgjegjës për konceptimin dhe planifikimin e aktivitetit, minimalisht me gradën doktor.
  - b. komiteti organizativ, që bën miratimin e planit organizativ të aktivitetit, si dhe mbikqyr zbatimin e tij. Komiteti organizativ duhet të ketë, minimalisht tre pjesëmarrës, nga të cilët: një person përgjegjës për zbatimin dhe

sigurimin e mbarëvajtjes së aktivitetit dhe një person përgjegjës për menaxhimin/arkivimin e të dhënave dhe informacionit.

5. Ofruesi duhet të provojë dhe garantojë zhvillimin e aktivitetit të edukimit në vazhdim në mjedise:
  - me ajër të kondicionuar ose ajrosje natyrale të përshtatshme;
  - me ndriçim të plotë dhe të garantuar edhe për raste emergjente;
  - të pajisura me aparaturat/mjetet e nevojshme për realizimin e aktivitetit;
  - me sipërfaqe të përshtatshme për përmbushjen e qëllimeve të aktivitetit, duke ruajtur distancimin e nevojshëm fizik dhe kriteret e tjera mjekësore për të mrojtur shëndetin e pjesëmarrve, sipas normave higjeno-sanitare në fuqi.
6. Ofruesi duhet të sigurojë përkthim për pjesëmarrësit në rastet kur aktiviteti apo një pjesë e tij zhvillohet në gjuhë të huaj.

## **1.2. Kriteret për mbështetjen financiare**

1. KEVP-ja nuk pranon kërkesa për akreditim të aktiviteteve të edukimit në vazhdim nga subjekte që prodhojnë ose tregtojnë instrumenta, të cilat përdoren nga psikologët, të cilët, në kuptim të kësaj rregulloreje, do të konsiderohen palë të interesit tregtar.
2. Këta të fundit, mund të mbështetin financiarisht aktivitete të edukimit në vazhdim, vetëm kur garantohet se vendimet që do të merren në secilën prej fushave të mëposhtme do të jenë të pavarura dhe nuk do të jenë nën ndikimin e palëve me interes tregtar.
3. Ofruesi nuk duhet të detyrohet nga pala e interesit tregtar për të marrë këshilla apo shërbime që lidhen me lektorët, autorët, pjesëmarrësit apo çështjet e edukimit, përfshirë këtu edhe përmbajtjen, si kusht i marrjes së fondeve.
4. E gjithë mbështetja financiare për aktivitetin e edukimit në vazhdim duhet të menaxhohet vetëm nëpërmjet ofruesit (institucionit që ka bërë kërkesën për akreditim pranë institucionit akreditues).
5. Marrëveshjet për prezantimet tregtare ose publiciteti nuk duhet të ndikojnë në planifikimin ose në implementimin e një aktiviteti të edukimit në vazhdim dhe as nuk mund të jenë kusht për ofrimin e mbështetjes financiare për aktivitetin.

---

## **A2. PROCESI I AKREDITIMIT**

### **1. Aplikimi për akreditim**

1. Për çdo aktivitet të edukimit në vazhdim bëhet një aplikim i veçantë pranë KVEP.
2. Aplikimi shoqërohet me pagesën e tarifës paraprake për akreditim, sipas kësaj rregulloreje. Procedurat e akreditimit për aktivitetet që kryhen nga institucionet publike për punonjësit e vet janë pa pagesë.
3. Akreditimi nga KVEP për një aktivitet është i vlefshëm për 12 muaj. Për përsëritjen e aktiviteteve që janë akredituar më parë nga KEVP-ja, nëse nuk ka asnjë ndryshim në përmbajtje apo në stafin akademik (lektor, udhëheqës, moderator, trajnues, etj.), ofruesi, pa ndjekur procedurat për aplikim, ka detyrimin të dërgojë në KEVP një njoftim të thjeshtë me shkrim, të shoqëruar me të dhënat përkatëse për aktivitetin, të paktën 15 ditë kalendarike përpara zhvillimit të tij. Procedurat për monitorimin, vlerësimin përfundimtar dhe shpërndarjen e krediteve të aktivitetit zbatohen njësoj sipas kësaj rregulloreje.
4. Aplikimi duhet të përmbajë dokumentacionin provues sipas listës dhe formatit të paraqitur në Shtojcën 1 të kësaj rregullore, si dhe çdo material tjetër që është i vlefshëm për qëllimet e akreditimit, së bashku me vlerësimin e brendshëm të aktivitetit.

### **5. VLERËSIMI I BRENDSHËM**

Vlerësimi i brendshëm kryhet nga vetë institucioni ofrues i aktivitetit të edukimit në vazhdim dhe shërben si bazë për vlerësimin e jashtëm që kryhet nga KVEP nëpërmjet një eksperti të pavarur. Ai identifikon nevojat për edukim në vazhdim dhe metodat më të mira për përmbushjen e tyre. Të dhënat e ofruara nga aplikuesi duhet të pasqyrojnë me vërtetësi informacione për tre komponentët kryesorë, që janë:

#### **5.1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E AKTIVITETIT TË EDUKIMIT NË VAZHDIM;**

**5.1.1.** Ofruesi duhet të paraqesë qëllimin e aktivitetit të edukimit në vazhdim, i cila duhet të përmbajë të gjithë komponentët bazë (fushat që do të përfshijë, llojin e aktivitetit, rezultatet e pritshme), ku rezultatet të jenë formuluar bazuar në termat e ndryshimeve që aktiviteti do të sjellë në njohuritë ose praktikën e profesionistëve.

**5.1.2.** Ofruesi duhet të përcaktojë se cilat nevoja për edukim në vazhdim, të shprehura në njohuri, kompetenca ose praktika, do të adresohen në aktivitetin e propozuar të edukimit në vazhdim. Objektivat e aktiviteteve të edukimit në vazhdim të shërbejnë për të orientuar hartimin e aktivitetit sa më pranë nevojave reale për zhvillim profesional të profesionistëve të psikologjisë.

**5.1.3.** Ofruesi duhet të hartojë aktivitete, të cilat kanë për qëllim të ndryshojnë njohuritë, aftësitë dhe performancën e psikologut, të parashikuara në qëllimin e deklaruar të aktivitetit. Ofruesi duhet të zgjedhë forma edukimi (metoda pedagogjike), të cilat janë të përshtatshme për tematikën, objektivat dhe rezultatet e pritshme të aktivitetit. Objektivat e aktivitetit të edukimit në vazhdim duhet të jenë objektiva të zhvillimit të njohurive dhe aftësive:

- a) tekniko-profesionale individuale, sipas fushave të veçanta të çdo kategorie apo specialiteti (objektiva të nivelit individual);
- b) për rritjen e cilësisë, efikasitetit, efikasitetit dhe siguri më të lartë, në raport me institucionet ose shërbimet ku profesionistët e psikologjisë punojnë;

**5.1.4.** Ofruesi duhet të bëjë një lidhje të drejtpërdrejtë e domethënëse të objektivave të paraqitura me përmbajtjen e programit dhe teknikat pedagogjike për çdo aktivitet të planifikuar prej tij.

**5.1.5.** Ofruesi duhet të organizojë aktivitete të pavarura nga interesat tregtare.

**5.1.6.** Ofruesi duhet të menaxhojë, në mënyrë të përshtatshme mbështetjen (financimin, fondet) tregtare.

**5.1.7.** Ofruesi duhet ta mbajë të ndarë promovimin tregtare nga pjesa edukative e aktivitetit.

## **5.2. PLANIFIKIMIN E AKTIVITETIT**

**5.2.1** Ofruesi duhet të demonstrojë një proces planifikimi të aktivitetit, i cili gërsheton nevojat e identifikuara për edukim në vazhdim me rezultatet e parashikuara të aktivitetit, si dhe duhet të përdorë të dhëna të bazuara në vlerësimin e nevojave për hartimin dhe planifikimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim;

**5.2.2.** Ofruesi duhet të garantojë pjesëmarrjen reale të psikologëve në aktivitetin e edukimit në vazhdim. Kjo mund të realizohet në mënyra të ndryshme, si nënshkrim për pjesëmarrje, verifikim elektronik i pjesëmarrjes, formular vlerësimi për aktivitetin i nënshkruar nga pjesëmarrësi, regjistër, etj.

### **5.3. VLERËSIMIN DHE PËRMIRËSIMIN E AKTIVITETIT**

**5.3.1** Ofruesi duhet të ketë parashikuar vlerësimin e efikasitetit të aktivitetit të edukimit në vazhdim në përmbushjen e nevojave të identifikuara paraprakisht;

**5.3.2.** Ofruesi duhet të bëjë përmirësimet e nevojshme, të sugjeruara nga procesi i vlerësimit.

**5.3.3.** Ofruesi duhet të analizojë ndryshimet të pjesëmarrësit (njohuritë, praktikat ose përfitimet e pacientëve), të arritura si rezultat i të gjitha aspekteve të aktivitetit të edukimit në vazhdim.

**5.3.4.** Ofruesi duhet të identifikojë, planifikojë dhe zbatojë ndryshimet e nevojshme ose të dëshiruara në aktivitet (p.sh., planifikuesit, trajnuesit, infrastrukturën, metodat, burimet, mjetet, ndërhyrjet), që janë të nevojshme për përmirësimin e cilësisë së aktiviteteve të ardhshme të edukimit në vazhdim.

---

## **A3. VLERËSIMI I APLIKIMIT NGA KVEP**

1. Brenda 7 ditësh nga regjistrimi i aplikimit, kryetari i KVEP cakton një ekspert të pavarur, i cili është përgjegjës për kryerjen e vlerësimi të jashtëm, monitorimin e mbarëvajtjes së aktivitetit dhe kryerjen e vlerësimit përfundimtar.

### **1.1. EKSPERTËT E PAVARUR**

Ekspertët e pavarur caktohen sipas fushës përkatëse, me rotacion, nga lista e ekspertëve, e miratuar paraprakisht nga KVEP. Lista e ekspertëve është e përditësueshme, mbi bazën e kërkesave. Kriteret për të qenë ekspertë përcaktohen nga KVEP nga rradhët e psikologëve me eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet.

1.2. Ekspertët e përfshirë në procesin e vlerësimit të jashtëm të një aktiviteti të edukimit në vazhdim duhet të deklarojnë paraprakisht me shkrim çdo

konflikt të mundshëm interesi me ofruesin e aktivitetit të edukimit në vazhdim. Gjithashtu, eksperti i përzgjedhur për vlerësimin e jashtëm të një aktiviteti nuk duhet të jetë i përfshirë në planifikimin, organizimin dhe zbatimin e aktivitetit që vlerësohet prej tij.

1.3. Në rast të mos kryerjes së detyrës brenda afateve dhe me cilësi, kryetari i KVEP, rast pas rasti, në varësi të fazës në të cilën ndodhet akreditimi, mund të vendosë:

a) zëvendësimin e ekspertit.

b) vijimin e procedurës së akreditimit pa pjesëmarrjen e ekspertit në proces, bazuar mbi të dhënat e paraqitura nga ofruesi.

Në rast se mos kryerja e detyrës ka ndodhur për fajin e ekspertit, KVEP mund të vendosë përjashtimin e ekspertit nga lista për një periudhë deri në 5 vjet.

1.4. Eksperti i pavarur paguhet me honorare nga Urdhri i Psikologut sipas kësaj rregulloreje, me përjashtim të rastit kur është zëvendësuar apo përjashtuar nga procesi me vendim të KVEP.

## **2. VLERËSIMI I JASHTËM**

2.1. Brenda 10 ditëve nga marrja e detyrës, eksperti i pavarur kryen vlerësimin e jashtëm, i cili realizohet nëpërmjet vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur për aplikim dhe përputhshmërisë së tij me vlerësimin e brendshëm të paraqitur nga ofruesi.

2.2. Eksperti shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi dhe, nëse ai është i plotë:

a) bën vlerësimin e tij sipas kriterëve të cilësisë në planifikimin e aktivitetit, përfshirë vlerësimin e burimeve të përdorura (trajnerët, materialet pedagogjike).

b) bën vlerësimin e përmbajtjes së kurrikulave që do të përdoren në aktivitet dhe përpërputhshmërinë e tyre me nevojat e pjesëmarrësve. Në varësi të këtij vlerësimi, eksperti mund të sugjerojë se cilat tema duhen konsideruar ose jo në llogaritjen e krediteve.

c) koordinon me ofruesin për plotësimin e dokumentacionit të kërkuar.

- d) kryen verifikime/inspektime për të garantuar që situata në terren përputhet me kriteret e përcaktuara dhe me deklarimet e bëra nga ofruesi.
- e) bën përlogaritjen e numrit të krediteve bazuar në llojin e aktivitetit dhe ia propozon për miratim KVEP
- f) harton bazuar në sa më sipër vlerësimin e jashtëm dhe ia paraqet KVEP

### **2.1. Llogaritja e krediteve për aktivitetet me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë:**

1. Kur numri i pjesëmarrësve është deri në 100 veta, përlogaritja e krediteve kryhet sipas kriterit “një kredit për çdo orë”. Kur numri i pjesëmarrësve është 101–200 veta, përlogaritja e krediteve kryhet sipas kriterit “0.7 kredite për çdo orë”, ndërsa për aktivitete me mbi 200 pjesëmarrës zbatohet kriteri “0.5 kredite për çdo orë”. Në rastet e aktiviteteve që zhvillohen në salla paralele, përlogaritja e numrit të pjesëmarrësve bëhet veçmas për çdo sallë.
2. Për trajnime të individualizuara, që përfshijnë fitimin e njohurive dhe të aftësive në kryerjen e procedurave apo të teknikave të reja, me jo më shumë se 5 pjesëmarrës, përlogaritja e numrit të krediteve bëhet sipas kriterit “1.5 kredite për çdo orë”.
3. Përlogaritja bazohet vetëm në kohëzgjatjen efektive, që përfshin orët reale të mësimdhënies dhe të ndërveprimit me pjesëmarrësit, duke mos përfshirë pushimet ndërmjet prezantimeve, seancën prezantuese të aktivitetit, etj.
4. Kohëzgjatja efektive e aktivitetit nuk duhet të kalojë 6 orë në ditë;
5. KEVP mund të bëhet një rritje 0.3 kredite për çdo orë për aktivitetet me tema në përputhje me fushat prioritare të miratuara paraprakisht prej saj.
6. Në rastet kur psikologu ka marrë pjesë si lektor/trajnues pa pagesë në një aktivitet të edukimit në vazhdim, kreditet që përfiton përlogariten në bazë të kohëzgjatjes së leksioneve të kryera nga lektori dhe kriterit 1 orë = 1.5 kredite, por jo më shumë se 6 kredite në ditë. Në rastet kur psikologu ka marrë pjesë si lektor/trajnues me pagesë në një aktivitet të edukimit vazhdues, atëherë, kreditet që regjistrohen përlogariten në bazë të kohëzgjatjes së leksioneve të kryera nga lektori dhe kriterit 1 orë = 0.5 kredite, por jo më shumë se 2 kredite në ditë.

### **3. Mbledhja e KVEP**

- 3.1. Pas dorëzimit të Vlerësimit të Jashtëm nga eksperti i pavarur, KVEP mblidhet brenda 30 ditëve dhe shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga ofruesi, vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm, dhe vendos përfundimisht në lidhje me miratimin e aplikimit për akreditim të trajnimit, si dhe numrin e krediteve përkatës për këtë aktivitet.
- 3.2. Vlerësimi i Jashtëm i kryer nga ekserti i pavarur nuk është detyrues për KVEP, i cili mund të marrë një vendim të ndryshëm në lidhje me miratimin e aktivitetit apo numrin e krediteve përkatëse të tij.
- 3.3. Në rast të plotësimit të pjesshëm nga ofruesi të dokumentacionit të kërkuar, KEVP-ja ruan të drejtën e refuzimit të akreditimit ose mosvlerësimit me kredite, për ato materiale të programit që kanë mangësi në dokumentacion apo në cilësinë e përmbajtjes. Në çdo rast, KVEP rezervon të drejtën të kërkojë plotësimin e dokumentacionit ose të kërkojë dokumentacion shtesë nga ofruesi, duke i lënë një afat të caktuar, përpara se të shprehet me vendim për refuzimin e akreditimit të aktivitetit ose për mosvlerësimin me kredite për pjesë të aktivitetit.
- 3.4. Në rastet kur akreditimi refuzohet, aplikuesit duhet t'i kthehet një përgjigje me shkrim nga KEVP-ja, duke paraqitur arsyet e refuzimit dhe sugjerimet përkatëse për përmirësimin e planifikimit dhe hartimit të propozimeve të ardhshme.
- 3.5. Në rastet kur akreditimi miratohet, Vendimi i KVEP i njoftohet ofruesit të shërbimit dhe publikohet në faqen zyrtare të Urdhrit të Psikologut. Urdhri i Psikologut publikon në faqen e tij zyrtare të gjitha aktivitetet e edukimit në vazhdim të akreditura prej tij paraprakisht, për të nxitur pjesëmarrjen e psikologëve në këto aktivitete në mënyrë të informuar.

#### **4. Monitorimi dhe vlerësimi përfundimtar**

- 4.1. Ofruesi i akredituar duhet të njoftojë ekspertin e pavarur jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune përpara zhvillimit të aktivitetit për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të tij.
- 4.2. Eksperti i pavarur ka detyrimin të monitorojë aktivitetin e edukimit në vazhdim për të siguruar zbatimin e standardeve dhe kritereve të parashikuara. Pjesëmarrja e ekspertit të pavarur me qëllim monitorimin dhe vlerësimin e aktivitetit, duhet të jetë jo më pak se 70% të orëve efektive të secilës ditë të aktivitetit.
- 4.3. KEVP-ja, nëpërmjet çdo njërit prej anëtarëve të vet apo nëpërmjet stafit të administratës së Urdhrit të Psikologut, të ngarkuar për këtë qëllim nga kryetari I KVEP, ka të drejtë të monitorojë në mënyrë të rastësishme dhe pa njoftim paraprak aktivitetet që akreditohen prej saj.
- 4.4. Pas përfundimit të aktivitetit, ofruesi duhet të kryejë procesin e vlerësimit, duke dorëzuar pranë ekspertit të pavarur listën e pjesëmarrësve në aktivitet dhe rezultatet e procesit të vlerësimit të aktivitetit të kryera nga vetë ofruesi, si dhe nga pjesëmarrësit në aktivitet. Frekuentimi i pjesëmarrësve duhet të jetë jo më pak se 85% të orëve efektive të secilës ditë të aktivitetit.
- 4.5. Mbi bazën e vlerësimeve të mësipërme dhe të monitorimit të kryer prej tij, eksperti i pavarur kryen Vlerësimin Përfundimtar të aktivitetit dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin, i dorëzon brenda 15 ditëve pranë KVEP, së bashku me rekomandimet përfundimtare.
- 4.6. Brenda 30 ditëve nga dorëzimi i raportit përfundimtar nga eksperti i pavarur, KVEP mblidhet dhe vendos:
  - a) miratimin e shpërndarjes së krediteve
  - b) anulimin e akreditimit të aktivitetit
  - c) rishikimin e numrit të krediteve
- 4.7. KEVP-ja mund të anulojë akreditimin e ofruar apo të rishikojë numrin e krediteve kur vërehen shkeljet e mëposhtme:
  - a) Ndryshime në programin e aktivitetit, të cilat çënojnë cilësinë e tij dhe ndikojnë në përlllogaritjen e krediteve të miratuara;
  - b) Mosraportimi i konflikteve të interesit të organizatorëve ose/dhe trajnuesve në aktivitet;
  - c) Përdorimi i aktivitetit për promovim personal ose tregtar;

- d) Keqpërdorimi i emrit të institucionit akreditues dhe krediteve të njohura prej tij;
  - e) Mosplotësimi i dosjes me dokumentacionin e nevojshëm për fazën pas aktivitetit;
  - f) Vlerësimi negativ i shumicës së pjesëmarrësve për organizimin e aktivitetit, përmbajtjen e temave të veçanta ose nivelin pedagogjik të paraqitjes së këtyre temave;
  - g) Mosdeklarim i mbështetjes financiare ose deklarim i rremë në aplikimin për akreditim.
  - h) Shkelje të tjera të rënda të kriterëve të kësaj rregulloreje.
- 4.8. Në rastet kur vihen re shkelje të kriterëve, në varësi të formës dhe rëndësisë së tyre, merr masën e pezullimit të përkohshëm për akreditimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim për ofruesin për një periudhë deri në një vit ose refuzon miratimin e një aktiviteti për të cilin ky ofrues ka aplikuar;
- 4.9. Në rastet kur vendos miratimin e shpërndarjes së krediteve, KVEP njofton ofruesin për pagesën e tarifës së mbetur, e cila duhet të kryhet jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së njoftimit, si dhe për përgatitjen e Çertifikatave (Dëshmime) të Pjesëmarrjes dhe dorëzimin e tyre për tu sigluar pranë Urdhrit të Psikologut.
- 4.10. Pas pagesës së tarifës së plotë, KVEP merr masa për pasqyrimin e krediteve të shpërndara në dosjen personale të psikologëve dhe në regjistrin përkatës.
- 4.11. Çertifikatat (Dëshmitë) e Pjesëmarrjes tërhiqen pranë Urdhrit të Psikologut nga ofruesi i aktivitetit dhe u shpërndahen pjesëmarrësve.

## **5. Tarifa e akreditimit**

1. Tarifa e plotë për akreditimin e një akteviteti me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë është në masën 200 lekë për cdo kredit të miratuar për shpërndarje dhe përbëhet nga:
  - a) tarifa paraprake, e cila parapaguhet në momentin e aplikimit dhe është e pakthyeshme, pavarësisht mënyrës së përfundimit të procesit të akreditimit, e specifikuar sipas pjesëmarrjes së planifikuar në aktivitet, si më poshtë:
 

|                                     |             |
|-------------------------------------|-------------|
| Aktivitete me mbi 200 pjesëmarrës   | 50 000 lekë |
| Aktivitete me 100 – 200 pjesëmarrës | 25 000 lekë |
| Aktivitete me 50 – 100 pjesëmarrës  | 20 000 lekë |

|                                   |             |
|-----------------------------------|-------------|
| Aktivitete me 20 – 50 pjesëmarrës | 15 000 lekë |
| Aktivitete me 5 - 20 pjesëmarrës  | 10 000 lekë |
| Aktivitete deri në 5 pjesëmarrës  | 5. 000 lekë |

- b) tarifa e mbetur, që përbën diferencën midis tarifës së plotë dhe asaj të paraprahe të parapaguar, e cila kryhet pas miratimit të shpërndarjes së krediteve, por përpara shpërndarjes së Çertifikatave (Dëshmime) të Pjesë marrjes dhe regjistrimit të krediteve në dosjet personale dhe regjistrin përkatës.
2. Moskryerja e pagesës së plotë nga ofruesi brenda 15 ditëve nga data e njoftimit është shkak për anulimin e akreditimit të aktivitetit dhe mosregjistrimit të krediteve për psikologët. Në këtë rast, çdo psikolog, pasi të ketë shlyer personalisht pjesën përkatëse të tarifës së plotë, ka të drejtë të kërkojë brenda një viti nga marrja dijeni nëpërmjet njoftimit publik, regjistrimin e krediteve të veta, duke ruajtur të drejtën që t'i kthehet nga ofruesi pagesa e plotë e kryer për trajnimin. KVEP, në çdo rast të tillë, është i detyruar të njoftojë organet e drejtësisë.
  3. Numri i pjesëmarrësve në një trajnim të akredituar nuk mund të tejkalojë më shumë se 10% të numrit të pjesëmarrësve të deklaruar në aplikimin fillestar dhe pagesën paraprahe.

## **B. AKTIVITETE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM NË DISTANCË (STANDARDET, KREDITET DHE PROCEDURAT)**

1. Për akreditimin e aktiviteteve të edukimit në distancë zbatohen të njëjtat parime, standarde, kritere dhe procedura akreditimi, si për edukimin me pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë, përveç atyre që lidhen me mjedisin ku kryhet aktiviteti.

### **A1. STANDARDE TË VEÇANTA TË EDUKIMIT NË VAZHDIM NË DISTANCË**

1. Përveç sa më sipër, për aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm në distancë, ofruesi duhet:

1. të deklarojë formatin e nevojshëm të teknologjisë së përdorur dhe mjetet e përshtatshme nëpërmjet të cilave kjo teknologji është e aksesueshme, duke u siguruar që pjesëmarrësit të jenë në gjendje të përdorin lehtësisht teknologjinë e duhur të informacionit, hardëar-in dhe softëar-in që nevojitet, për të arritur qëllimet e aktivitetit;
2. të deklarojë kohëzgjatjen në orë të kohës që pjesëmarrësit do t'i duhet për të përmbushur objektivat edukativë të aktivitetit;
3. të ofrojë gjatë të gjithë kohës mbështetje teknike për pjesëmarrësit, në lidhje me ndjekjen e aktivitetit;
4. të garantojë një mënyrë të qartë për konfirmimin e përfshirjes së pjesëmarrësit, si dhe të përmbushjes së objektivave të aktivitetit;
5. të respektojë e të konfirmojë konfidencialitetin e pjesëmarrësit, si dhe faktin që çdo informacion, për pjesëmarrësit në aktivitet, do të përdoret vetëm për qëllimet specifike të përmbushjes së kërkesave të këtij aktiviteti. Rastet e vetme të përjashtimit duhet të jenë me informimin dhe miratimin e plotë të pjesëmarrësit.
6. të vërtetojë një përvetësim nga pjesëmarrësit deri në 70% të njohurive të reja nga ndjekja e aktivitetit të edukimit në distancë (përqindja kaluese), sipas testimeve të kryera në bazë të llojit të aktivitetit.

---

## **A2. LLOJET E EDUKIMIT NË VAZHDIM NË DISTANCË:**

Edukimi në vazhdim në distancë janë:

- Aktivitetet e edukimit në distancë, sinkron (të njëkohshëm)
- Aktivitetet E-Learning

### **1. STANDARDE DHE KRITERE SHITESË, SIPAS LLOJIT TË AKTIVITEVE TË EDUKIMIT NË VAZHDIM NË DISTANCË**

#### **1.1. AKTIVITETET E EDUKIMIT NË DISTANCË SINKRON (TË NJËKOHSHËM)**

1. Për aktivitetet e edukimit në distancë, sinkron (të njëkohshëm), pjesëmarrja në leksione ose sesione edukuese, që zhvillohen larg vendit ku është psikologu, duhet të arrihet nëpërmjet përdorimit të një platforme multimediale të dedikuar (klasa virtuale, ëebinar), nëpërmjet lidhjes me internetin, e cila garanton ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave, sipas standardeve ndërkombëtare.
2. Pjesëmarrja e njëkohshme duhet të parashikojë lidhjen në internet të pjesëmarrësve në orare të caktuara që më parë nga programi mësimor dhe të garantojë një nivel të lartë ndërveprimi ndërmjet lektorëve/tutorëve dhe pjesëmarrësve.
3. Çdo orë mësimi, përfshirë edhe ndërhyrjet e pjesëmarrësve, duhet të regjistrohet dhe të jetë e disponueshme për t'u verifikuar, përdorur apo përsëritur në një moment tjetër. Regjistrimi duhet të ruhet për të paktën 2 vjet.
4. Pjesëmarrja individuale në aktivitet duhet të verifikohet me anë të regjistrimit të lidhjeve online në platformë gjatë gjithë kohës së aktivitetit.
5. Verifikimi i dijeve duhet të bëhet nëpërmjet testit që kryhet në përfundim të sesionit.

## **1.2. AKTIVITETET E-LEARNING**

Për aktivitetet E-Learning:

1. Ofruesi duhet të sigurojë përdorimin e materialeve didaktike në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritshme, me anë të teknologjive multimediale, nëpërmjet lidhjes me internetin;
2. Ofruesi duhet të përdorë një platformë teknologjike, e cila i dedikohet edukimit dhe garanton përdorimin pa pasur nevojë për orare të caktuara apo të qenit të pranishëm në vende të përcaktuara që më parë;
3. Platforma teknologjike duhet të garantojë përdorimin e lehtë të saj, regjistrimin e përdoruesve, mundësinë për dhënien e pëlqimit për privatësinë dhe trajtimin e të dhënave të përdoruesve, verifikimin e veprimeve të kryera nga përdoruesit në platformë dhe të jetë në gjendje të masë nivelin e përvetësimit të kurseve nga përdoruesit nëpërmjet testeve vlerësuese dhe testeve për shkallën e pëlqimit të çdo kursi edukues;

4. Platforma teknologjike duhet të parashikojë një apo më shumë module të edukimit/të formimit, si dhe procese të ndërmjetme vetëvlerësimi;
5. Verifikimi i pjesëmarrjes duhet të sigurohet me anë të testeve për lëndët e dhëna dhe duhet të garantohet nga kontrolli i veprimeve të kryera nga sistemi.
6. Përveç sa më sipër, duhet të parashikohen edhe verifikime të veçanta të identitetit të psikologut pjesëmarrës në aktivitet.

---

### **A3. APLIKIMI PËR EDUKIMIN NË DISTANCË**

1. Në momentin e aplikimit, ofruesi i shërbimit në distancë, përveç dokumentacionit të kërkuar në rastet e aktiviteteve me pjesëmarrje të drejtëpërdrejtë, duhet të paraqesë edhe të gjithë informacionin e kërkuar sa më sipër, duke specifikuar çdo të dhënë teknike që mundëson ekspertin e caktuar nga KVEP të kryejë verifikimet përkatëse të teknologjisë së përdorur, të monitorojë zhvillimin e aktivitetit në kohë reale dhe të marrë të dhënat e nevojshme për hartimin e raportit përfundimtar.
2. KEVP ka të drejtën e refuzimit të miratimit të aktivitetit të edukimit në vazhdim në distancë, pavarësisht nga përmbajtja e tij, nëse platforma apo teknologjia e përdorur nuk është në standardet më të larta ndërkombëtare apo kur gjykon se mbrojtja e të dhënave të pjesëmarrësve mund të jetë e kompromentuar.

## C. AKTIVITETE TË VETËRAPORTUARA NGA PSIKOLOGU

Aktivitetet e vetëraportuara nga psikologu janë:

1. Aktivitetet kërkimore/studimore
2. Supervizimi

---

### C1. AKTIVITETET INDIVIDUALE KËRKIMORE/STUDIMORE

1. “Aktivitet kërkimor/studimor”, konsiderohet përfshirja e psikologut në punë kërkimore, në shkrime artikujsh apo materialesh të tjera profesionale dhe shkencore, të realizuar nëpërmjet botimeve në revista shkencore, botimeve të teksteve mësimore, recensimit të botimeve, si dhe realizimit të posterave dhe abstrakteve.

2. Përlllogaritja e krediteve për aktivitetet e kësaj kategorie bëhet nga KVEP, si më poshtë:

| Lloji i aktivitetit                                                                            | Nr. krediteve |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|
| <b>Botim artikulli në revistë shkencore</b>                                                    |               |
| Revistë shkencore me faktor impakti e rankuar nga <i>Thomson Reuters</i> dhe/ose <i>Scopus</i> |               |
| Autor i Parë                                                                                   | 15-20 kredite |
| Autor i Dytë                                                                                   | 10-15 kredite |
| Autor i tretë                                                                                  | 5-10 kredite  |

|                                                                                  |              |
|----------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| Mbi 3 Autorë                                                                     | 0-55 kredite |
| Revistë shkencore e indeksuar në regjistër ndërkombëtar (ISSN) pa faktor impakti | 5-10 kredite |
| Autor i Parë                                                                     | 8-10 kredite |
| Autor i Dytë                                                                     | 6-8 kredite  |
| Mbi 3 Autorë                                                                     | 5-6 kredite  |

Revistë shkencore e paindeksuar në regjistër kombëtar ose ndërkombëtar dhe pa faktor impakti 2-7 kredite

|              |             |
|--------------|-------------|
| Autor i Parë | 5-7 kredite |
| Autor i Dytë | 3-5 kredite |
| Mbi 3 Autorë | 2-3 kredite |

### **Botim i teksteve mësimore**

|                                            |                 |
|--------------------------------------------|-----------------|
| Tekst pasuniversitar                       | 25 - 50 kredite |
| Monografi                                  | 50 kredite      |
| Tekst mësimor për studentët e psikologjisë | 20 -30 kredite  |

### **Recensimi i botimeve**

|                                                                |               |
|----------------------------------------------------------------|---------------|
| Recensimi i tekstit mësimor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar | 10-15 kredite |
| Recensimi i artikullit në nivel kombëtar                       | 3 kredite     |
| Recensimi i artikullin në nivel ndërkombëtar                   | 5 kredite     |

### **Abstrakt/Poster i botuar në librin përmbledhës të një:**

|                                      |              |
|--------------------------------------|--------------|
| Konferencë e zhvilluar jashtë vendit | 7-10 kredite |
| Konferencë e zhvilluar brenda vendit | 4-6 kredite  |

Pavarësisht nga numri i abstrakteve ose posterave të botuara brenda të njëjtit aktivitet, vlerësimi bëhet vetëm për një të tillë.

Trajnime të zhvilluara jashtë vendit, në një nga vendet G-20 dhe pjesë e EFPA-s 2-10 kredite.

Aplikuesit të dorëzojnë dokumentacionin provues për aktivitetin: çertifikatën e trajnimit ;axhendën ;të dhëna për trajnuesin si dhe materiale të tjera plotësuese lidhur me aktivitetin.

Pjesëmarrje në Konferenca të zhvilluara jashtë vendit në një nga vendet G-20 dhe pjesë e EFPA-s, si dhe pjesëmarrja në Konferenca të zhvilluara në institucione të akredituara brenda vendit 1-3 kredite.

Aplikuesit të dorëzojnë dokumentacionin provues për aktivitetin: çertifikatën e pjesëmarrjes ;axhendën si dhe materiale të tjera plotësuese lidhur me aktivitetin.

---

## **C2. SUPERVIZIMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE**

1. “Supervizimi i praktikës profesionale” konsiderohet ushtrimi zyrtarisht i përgjegjësive të supervisorit, në përputhje me rregulloren për kryerjen e praktikës profesionale të Urdhrit të Psikologut. Rregjistrimi i krediteve të fituara si pasojë e supervizimit kryhet me kërkesë të psikologut, vetëm pasi praktikanti nën suervizim të ketë kaluar me sukses Vlerësimin e Aftësimit Praktik.

2. Përlllogaritja e krediteve të fituara nga supervizimi bëhet nga KVEP, si më poshtë:

### **Supervizimi i praktikave profesionale**

Supervisor me eksperiencë profesionale deri në 10 vjet

10

Supervisor me ekspierncë profesionale 10 deri në 20 vjet

15

3. Kërkesa për njohjen dhe regjistrimin e krediteve të raportuar nga psikologu bëhet pranë KEVP-së individualisht nga psikologu, jo më vonë se 1 vit nga dita kur ka ndodhur aktiviteti apo kur këto kredite janë bërë të regjistrueshme. Ky afat mund të zgjatet nga KVEP vetëm për arsye objektive të dokumentuara ose të njohura botërisht.
4. Kërkesa bëhet në formatin e miratuar nga KVEP (shtojca X), shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm provues.
5. KEVP ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë, edhe tek palë të treta, informacion apo dokumentacion shtesë për të verifikuar autenticitetin dhe origjinalitetin e përmbajtjes së aktivitetit kërkimor/studimor të raportuar. KEVP ka të drejtë të revokojë në çdo kohë vendimin e marrë më parë për shpërndarjen e krediteve, nëse provohet se informacioni i raportuar ka qënë i rremë ose përmbajtja e aktivitetit nuk është origjinale, dhe i referon për shqyrtim çështjen Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Profesional.

## **KREU IV**

### **PROCEDURA TË VEÇANTA AKREDITIMI**

#### **A. AKREDITIMI I NJË AKTIVITETI ME PJESËMARRJE TË DREJTËPËRDREJTË PAS KRYERJES SË TIJ**

1. KVEP mund të miratojë njohjen dhe shpërndarjen e krediteve pas kryerjes së një aktiviteti me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë, edhe pas kryerjes së aktiviteti në rastet kur:
  - a) aktiviteti kryhet nga nje organizatë ndërkombëtare ku Urdhri i Psikologut është anëtar ose ka një marrëveshje mirëkuptimi/bashkëpunimi
  - b) aktiviteti kryhet nga nje institucion publik ose institucion i arsimit të lartë, i cili për nga struktura dhe organizimi administrativ garanton cilësinë e aktivitetit,

monitrimin dhe vlerësimin e tij, në përputhje me standardet dhe kriteret e kësaj rregullore, në qoftë se ka një marrëveshje midis Urdhrit të Psikologut dhe institucionit për këtë qëllim.

c) në çdo rast tjetër kur Këshilli Kombëtar ka dhënë pëlqimin për njohjen e aktivitetit

2. Në këtë rast, kërkesa për njohjen e krediteve paraqitet nga vetë institucioni ose nga psikologët pjesëmarrës dhe shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton pjesëmarrjen e psikologëve në aktivitet, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e aktivitetit dhe vlerësimin e aktivitetit nga institucioni.

3. KVEP shqyrton kërkesën dhe vendos, në përputhje me përmbajtjen e aktivitetit, për shpërndarjen ose jo të krediteve, pa cënuar parimet bazë të kësaj rregullore për aktivitet me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë.

4. Përveç rasteve kur aktiviteti është kryer për nevoja të punonjësve të vetë institucionit, përpara regjistrimit të krediteve, çdo psikolog ose një person i autorizuar, paguan tarifën e plotë të akreditimit për çdo psikologë, si në rastin e akreditimit të çdo aktiviteti me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë.

5. Pas pagimit të tarifës së plotë të akreditimit, pjesëmarrësit pajisen me një vërtetim të veçantë për shpërndarjen dhe regjistrimin e krediteve të tyre nga Urdhri i Psikologut.

## **B. AKREDITIMI I NJË AKTIVITETI ME PJËMARRJE TË DREJTPËRDREJTË ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR**

1. KVEP mund të akreditojë me procedurë të përshpejtuar kryerjen e një aktiviteti me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë, kur aktiviteti kryhet nga një institucion publik ose Institucion i Arsimit të Lartë.

2. Në këtë rast, kërkesa e thjeshtë për akreditim paraqitet nga institucioni dhe shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që lidhet me organizimin e aktivitetit, duke specifikuar përmbajtjen, lektorët dhe kohëzgjatjen e aktivitetit. Pagesa e tarifës paraprake për akreditim nuk është e nevojshme.

3. Kryetari i KVEP, jo më vonë se 5 ditë përpara datës së kryerjes së aktivitetit, cakton një ekspert të pavarur për monitorimin e tij dhe hartimin e raportit përfundimtar.

4. Brenda 15 ditëve nga përfundimi i aktivitetit, eksperti i pavarur paraqet raportin përfundimtar dhe rekomandimet përkatëse pranë KVEP, duke bërë edhe përlllogaritjen e krediteve sipas llojit të aktivitetit.
5. KVEP, pasi merr në shqyrtim raportin përfundimtar të ekspertit, brenda 30 ditëve, vendos në lidhje me miratimin e kërkesës për akreditim dhe vendos për miratimin e shpërndarjes së krediteve.
6. Përpara regjistrimit të krediteve, çdo psikolog ose një person i autorizuar, paguan tarifën e plotë të akreditimit për çdo psikologë, si në rastin e akreditimit të çdo aktiviteti me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë.
5. Pas pagimit të tarifës së akreditimit, pjesëmarrësit pajisen me një vërtetim të veçantë për shpërndarjen dhe regjistrimin e krediteve të tyre ose, nëse është e mundur me Çertifikatën (Dëshminë) e Pjesëmarrjes të sigluar edhe nga Urdhri I Psikologut.

---

## **B1. AKREDITIMI I NJË AKTIVITETI TË ORGANIZUAR NGA URDHRI I PSIKOLOGUT**

1. KVEP mund të akreditojë me procedurë të përsheptuar kryerjen e një aktiviteti të organizuar nga Urdhri i Psikologut, nëse ky aktivitet kërkohet shprehimisht nga legjislacioni që të kryhet nga ky institucion, kur kjo është e nevojshme për shkak të detyrimeve që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare, ose sa herë çmohet e nevojshme për shkak të interesit publik.
2. Në këtë rast procedohet në të njëjtën mënyrë si për aktivitetet e akredituar me procedurë të përsheptuar, por Kryetari i KVEP (njëkohësisht President i Urdhrit) nuk ka të drejtë të marrë pjesë në votim. Funksionet e tij i kryen në këtë rast anëtari më i vjetër i KVEP.

## **KREU V**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. I gjithë dokumentacioni i programit të rilencimit duhet të ruhet nga UP- ja sipas legjislacionit në fuqi për arkivat dhe për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Anëtarët e Komisionit të Edukimit në Vazhdim paguhen me honorare, bazuar në numrin e mbledhjeve, në masën e caktuar me vendim nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga cilësia e tyre.

3. Ekspertët që përfshihet në procesin e akreditimit paguhen me honorare, në masën e caktuar me vendim nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, sipas llojit të aktevitetit si më poshtë:

- vlerësimi të një konference
- vlerësimi të një trajnimit
- vlerësimi të prezantimi të një leksioni
- vlerësimi të çdo lloj tjetër aktiviteti të edukimit në vazhdim

## **18. E DREJTA E ANKIMIT**

Kundër një vendimi përfundimtar të KVEP, çdo i interesuar ka të drejtën e ankimit pranë Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni të njoftimit të vendimit nga KEVP-ja.

## **KREU VI DISPOZITA KALIMTARE**

1. Psikologët e licencuar deri në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje rilicencohen me plotësimin e numrit të përgjithëm prej 80 kredite për të gjithë periudhën deri në momentin e rilicencimit.

2. Regjistrimi i aktiviteteve të vetëraportuara nga psikologët, të kryera pas miratimit të rregullores ekzistuese të edukimit në vazhdim, por përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje të re, mund të rregjistrohen brenda 1 vit nga data e hyrjes në fuqi të kësaj të fundit.